



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës për informacion, regjistruar me numër rendor 36 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 6277 prot., datë 06.12.2023, në të cilën kërkonti vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe historikut në lidhje me procedimin disiplinor ndaj gjyqtares znj. {...} në vitin 1996 (duke përfshirë kërkesën për inicimin e procedimit, raportin mbi hetimet që janë kryer, vendimin, etj) dokumentacion i KLD së kohës, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me periudhën për të cilën kërkonti informacion dhe dokumentacion, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001.

Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo edhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatishnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse.

Gjithashtu, sqarojmë se, për periudhën që ju kërkonti informacion dhe dokumentacion, më konkretisht për vitin 1996, për znj. {...}, emëruar me Vendimin nr. 14, datë 21.12.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtare pranë Gjykatës {...}, bazuar në Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se:

1. Vendimi nr. 7, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është liruar nga detyra për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës.
2. Vendimi nr. 8, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës {...}.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!